

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr.391/02-127017/24 dt. 26.09.2024, të kërkuësve/bashkëpronarëve Daut Hoxha, Shkelzen Beqiri, Ramë Ajeti, Zuka Beka, Din Hoti nga Prishtina dhe Investitori “Nderimi” sh.p.k. me përfaqësues Armend Aliu nga Vitia për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Lamelat: “A” dhe “B”, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “A-13”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, në rr. “**Venet Bajrami**”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë të rregullt administrative, me datë **15.10.2024**, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkuësve/bashkëpronarëve Daut Hoxha, Shkelzen Beqiri, Ramë Ajeti, Zuka Beka, Din Hoti nga Prishtina dhe Investitori “Nderimi” sh.p.k. me përfaqësues Armend Aliu nga Vitia, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-127017/24 dt. 26.09.2024, përdorimi i kompleksit me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Lamelat: “A” me etazhitet 2B+S+P+8, “B” me etazhitet 3B+S+P+7, të ndërtuar sipas “*Vendimit për Lejimin e Ndërtimit*”, 05 NR. 351/02-310295/19 dt. 18.03.2021, lëshuar kjo drejtori, në parcelën kadastrale nr. 1692-0, ZK Matiçan, konkretisht në kuadër të bllokut urban “A-13”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, në rr. “Venet Bajrami”, në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “**Venet Bajrami**” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: Nr. **83, 83/1, dhe 83/2**, në rruga në Prishtinë, dhe të njejtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësisve të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkuësit/bashkëpronarët Daut Hoxha, Shkelzen Beqiri, Ramë Ajeti, Zuka Beka, Din Hoti nga Prishtina dhe Investitori “Nderimi” sh.p.k. me përfaqësues Armend Aliu nga Vitia, me kërkesën 05 Nr.391/02-127017/24 dt. 26.09.2024, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksin me ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Lamelat: “A” me etazhitet 2B+S+P+8, “B” me etazhitet 3B+S+P+7, të ndërtuar në kuadër të bllokut urban “A-13”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, në rr. “Venet Bajrami”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1692-0, ZK Matiçan, ndërtuar sipas “*Vendimit për Lejimin e Ndërtimit*”, 05 NR. 351/02-

Faqe 1 prej 2

310295/19 dt. 18.03.2021 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09-391/02-222707/23 dt. 20.11.2023, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përkrahimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; **Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore**; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, Perparim Fazliu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Vullnet Neziri; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Muhedin Morina; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Asmir Hamdi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Shukri Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve për mbrojtje nga zjarri, nga mbikqyrësi Perparim Fazliu; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Faton Bajselmani me nr. të licensës 125;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat shumëbanesore me afarizëm mund të përdoren.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.


Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që kompleksi me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm.


Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-127017/24 DT. 15.10.2024**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu


Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi


Faqe 2 prej 2